

KUVENDI

NR 726 DATE 20.02.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

KRYETARI

D. Y. S. P. L. M. K. M. B.
D. Y. S. P. L. M. K. M. B.
D. Y. S. P. L. M. K. M. B.

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2020

Lënda: Depozitim nisme legislative

Drejtuar: Z. Gramoz RUÇI

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

K ËT U

I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit në cilësinë e nismëtarit, Ju paraqes nismën legislative Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ju faleminderit,

KRYETARI I GRUPIT PARLAMENTAR TË PSSH-së
12D2ABZ . 00. E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

P R O J E K T L I G J

Nr. _____ /2020

**PWR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10221, DATË
04.02.2010 “PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Taulant Balla,
KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon :

Neni 1

Në të gjithë përbajtjen e ligjit, emërtimi “Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohet me “*ministri/a përgjegjës i cështjeve sociale dhe çështjeve të punësimit*”, dhe termi “Ministria e Arsimit dhe Shkencës” zëvendësohet me termin “*ministri/a përgjegjës për cështjet e arsimit*”

Neni 2

Në nenin 1 shtohen termat, si më poshtë vijon :

1. Pas fjalës “.... të barazisë,” shtohen “*dhe mosdiskriminimit*”.
2. Pas fjalës “....gjuhën.....” shtohen “*shtetësinë*” .
3. Pas fjalës “.... orientim seksual.....” shtohen “*jetesa me “Hiv Aids”*”.
4. Pas fjalës “....predispozicione gjenetike.....” shtohen “*pamja e jashtme*”.

Pas nenit 3 shtohet nenl 3 / 1 , me këtë përbajtje:

Neni 3/1
Format e Diskriminimit

1. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

2.“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

3.“Diskriminimi i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në disa shkaqe që veprojnë veçmas.

4.“Diskriminimi ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në të njëjtën kohë në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.

. „3“Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsyet e shoqërimit me persona që u përkasin grupeve 2 3përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

. „3“Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mqedisi frikësues, armiqësor, përcmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

. „3“Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

. „3“Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gjëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për

personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

9. "Viktinizimi" është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit".

10. "Gjuha e urejtjes" është cdo formë e shprehjes, promovimit, nxitjes së denigrimit, urejtjes, shpifjes, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënëm ndaj një personi ose grupei personash, si dhe cdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes, e bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale sipas nenit 1 të këtij ligji.

11. "Ngacmimi seksual" është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, verbale ose jo-verbale, e natyrës seksuale, e cila ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mqedisi frikësues, armiqësor, përqëmues, poshtërues a ofendues për të".

12. "Segregim" është ajo formë diskriminimi e cila ndodh në rastet kur një person apo grup personash, veçohen nga të tjerët; persona fizik, juridik, sektori publik, privat, dhe ky veçim bëhet për të paktën një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji.

Neni 4

Pas nenit 3/1 shtohet nen1 3 /2 , me këtë përbajtje:

Neni 3/2

Format e rënda të diskriminimit

Sjellja diskriminuese e cila është motivuar nga më shume se një shkak , është kryer më shumë se një herë, ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore apo ka pasur pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimen, konsiderohet formë e rëndë e diskriminimit.

Neni 5

Pas nenit 4 shtohet nen1 4/1, me përbajtjen si më poshtë vijon:

Neni 4/1 Organizatat me interesa legjitimë

1.Organizatat me interesa legjitimë janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimate të diskriminimit.

2. Në rastet kur kërkohet zgjidhje ose propozime për të arritur qëllimet e këtij Ligji, Komisionieri mund të bashkëpunojë me partnerë socialë dhe organizata, institucionë ose organe jo shtetërore, të cilat veprojnë në fushën e barazisë, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mbrojtjes së grupeve vulnerabël kundër diskriminimit.

Neni 6

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime :

1. në shkronjën b pas fjalës “.....diplomë universitare...” shtohet “*në fushën e shkencave humane*”.
2. në shkronjën c pas fjalës “....të ligjit ...” shtohet “*dhe dhe të ketë eksperiencë mbi 5 vjet në këto fusha*”;

Neni 7

Në nenin 28 bëhen këto ndryshime

1. pika 1 shkronja b, riformulohet si më poshtë vijon:
b) verifikohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën për më shumë se tre muaj;
2. shtohet pika 2 me përbajtje si më poshtë:
Mocioni për shkarkimin e Komisionerit propozohet nga jo më pak se 1/3 e deputetëve të Kuvendit. Vendimi për shkarkimin nga detyra të Komisionerit merret me shumicën e 3/5 të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 8

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime :

1. pika 1, germa i) riformulohet si më poshtë vijon:
Vendos në lëvizje, me kërkesë, Gjykatën Kushtetuse, nenit 49 paragrafit 3, shkronjës c) të Ligjit Nr.8577 datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar”.
2. pika 2 riformulohet si më poshtë vijon:
Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke dhënë informacionin që i nevojitet por edhe duke garantuar aksesin në informacionin që i nevojitet në përbushjen e detyrave të tij.
3. pika 4 riformulohet si më poshtë vijon:

Detyrimi i përmendur në pikën 2 të këtij neni përbushet në përputhje me legjislacionin që rregullon të drejtën e informimit dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 9

Në nenin 33 bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1.Pika 2 riformulohet si më poshtë vijon:

Organizata me interesa legjitimë mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.

2.Pika 4 gërma a) shfuqizohet.

3.Pika 4 gërma dh) ndryshohet si më poshtë:

Paraqitet më vonë se 2 vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese.

4.Në pikën 5 zëvendësohet fjala “marrjes së” me fjalën “*regjistrimit të*”.

5.Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

Me regjistrimin e ankesës, Komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, Komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, Komisioneri merr informacion edhe nga çdo subjekt ose burim tjetër.”

6.Pas pikës 7 shtohen pika 7/1, 7/2, 7/3, 7/4 me përmbajtjen si më poshtë:

7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”

7/2. Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me shqyrtimin e ankesës, kërkohen njohuri të posaçme, Komisioneri, mund të kërkojë mendim të specializuar nga ekspertë të fushave të caktuara.

7/3. Në rastet kur ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, kanë të njëjtin objekt, mund të bashkohen në një ankesë të vetme.

7/4. Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e çështjes.”

7. Në pikën 10 togfjalëshi “....dita e marrjes së ankesës.....” zëvendësohet me “*dita e regjistrimit të ankesës*”.

8. Në pikën 11 termi “person” zëvendësohet me “*Subjekt*”.

9.Në pikën 13 pas togfjalëshit “....dispozitat e këtij ligji....” shtohet “përfshirë detyrimin për dhënie informacioni për shqyrtimin e çështjeve te diskriminimit, sipas nenit 32 pika 2 të këtij ligji”.

10.Pika 16 shfuqizohet.

11. Pika 17 shfuqizohet.

11. Pas pikës 15 shtohen pikat 16, 17, 18, me përmbajtje si më poshtë vijon:

16. Në rastet, kur Vendimi i Komisionerit kthehet mbrapsht nga posta me shënimin “**destinacion i panjohur**” ose “**destinacioni nuk gjendet**” dhe për rrjedhim ankuesi dhe subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa, nuk mund të marrin dijeni mbi masat e marra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përbledhja e vendimit afishohet në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

17. Mediat kombëtare kanë detyrimin që të publikojnë vendimet e diskriminimit të Komisionerit me objekt gjuhën e urrjetjes.

18. Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankimohen gjyqësisht në Gjykatën kopetente.

Neni 10

Pas nenit 33 shtohet neni 33/1 me këtë përmbajtje:

Neni 33/1

Ekzekutimi i gjobave dhe vendimeve të Komisionerit

1.Gjobat paguhen nga kundërvajtësi jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i tyre. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbartimit, me kërkesë të Komisionerit.

2. Gjoba arkëtohet në buxhetin e shtetit.

Neni 11

Pika 3, në neni.34, ndryshohet si më poshtë vijon:

Një organizatë me interes të ligjshëm mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklarim përpëra gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi.

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I
GRAMOZ RUÇI